



Legal Alert

December 2021



pwc

PwC Albania - Legal Alert

Proposal for changes in law no. 35/2016 “On Copyright and Other Related Rights”

The Parliament of the Republic of Albania is considering the draft law on some additions and amendments to Law no. 35/2016 "On Copyright and Other Related Rights".

This draft law is partially harmonized with Directive 2012/28 / EU “On certain permitted uses of orphan work”, Directive 2017/1564 / EU, “On certain permitted uses of certain works and other areas protected by copyright and other related rights for the benefit of persons who are blind, visually impaired or otherwise disabled with regard to printed materials” and Directive 2001/29 / EC “On the harmonization of certain aspects of copyright and other related rights in the information society”.

The draft law aims, among other things, to regulate the legislative framework related to orphan works, brings up the new concept of exhaustive research and the use of some works by a category of persons.

Changes are also foreseen in relation to the Collective Administration Agencies (“CAA”).

Some of the changes are as follows:

- The draft law introduces as a novelty the concept of orphan work. Orphan work are considered those works that, after conducting and documenting an exhaustive search, none of the authors or co-authors of the work has been identified or if the author or one or more co-authors of the work have been identified but their location is unknown.
- The author or co-author of the orphan work enjoys at any time the right to terminate the status as an orphan work in relation to his rights.
- An act that is considered an orphan act, in accordance with the law of each member state of the European Union will also be considered an orphan act in the Republic of Albania, without the need to carry out the exhaustive search procedure.
- According to the draft law, orphan work can be used unrestrictedly by educational institutions, public libraries, museums and other legal entities that perform museum activities, as well as in the collections of archives or archival film or audiovisual institutions. However, the author or co-author of the work, as soon as his identity becomes known, has the right to end this situation and be compensated for the use of his works.
- The draft law allows the use of copyrighted works for the needs of blind, visually impaired or otherwise disabled persons without the need to obtain an authorization and without the right to compensation.
- In order to provide an effective service for the user entities, the draft law provides for the creation of a unique counter that performs services for the function of collecting remuneration fees for all categories of holders of rights in collective administration, protected by all collective licensed administration agencies.

Source: [link](#)

Propozim për ndryshime në ligjin nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta të tjera të Lidhura me to”

Në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë është duke u shqyrtuar draft Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta të tjera të Lidhura me to”.

Ky projektligj është pjesërisht i harmonizuar me Direktivën 2012/28/BE “Për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor”, Direktivën 2017/1564/BE, “Mbi disa përdorime të lejuara të veprave të caktuara dhe fusha të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara” dhe Direktivën 2001/29/KE “Mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në shoqërinë e informacionit.”

Projektligji synon ndër të tjera rregullimin e kuadrit legjislativ referuar veprave pa autor, përfshin konceptin e ri të kërkimit shterues si dhe përdorimin e disa veprave nga një kategori personash.

Ndryshime parashikohen gjithashtu në lidhje me Agjencitë e Administrimit Kolektiv (“AAK”).

Disa prej ndryshimeve janë si më poshtë:

- Projektligji sjell si risi konceptin e veprës pa autor duke përfshirë ato vepra kur, pas kryerjes dhe dokumentimit të një kërkimi shterues, asnjë nga autorët ose bashkautorët e një vepre nuk është identifikuar ose nëse autori ose një a më shumë bashkautorë të veprës janë identifikuar, por asnjërit prej tyre nuk i dihet vendndodhja.
- Autori ose bashkautor i veprës pa autor gëzon në çdo kohë të drejtën t'i japë fund statusit si vepër pa autor në lidhje me të drejtat e tij.
- Një vepër që konsiderohet vepër pa autor në përputhje me ligjin e çdo shteti anëtar të Bashkimit Evropian do të konsiderohet, gjithashtu, një vepër pa autor edhe në Republikën e Shqipërisë, pa qenë nevoja për të kryer procedurën e kërkimit shterues
- Sipas projektligjit, veprat pa autorë mund të përdoren në mënyrë të pakufizuar nga institucionet arsimore, libraritë publike, muzetë dhe nga persona të tjerë juridikë që kryejnë veprimtari muzeore, si dhe në koleksionet e arkivave ose të institucioneve arkivore filmike ose audiovizuale. Gjithsesi, autori ose bashkautor i veprës në momentin që identiteti i tij behet i ditur, ka të drejtë t'i japë fund kësaj situatë dhe të kompesohet për përdorimin e veprave të tij.
- Projektligji lejon përdorimin e veprave me të drejtë autori për nevojat e personave të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara pa qenë nevoja për marrjen e një autorizimi dhe pa të drejtë kompesimi.
- Për të siguruar një shërbim efektiv për subjektet përdoruese, projektligji parashikon krijimin e një sporteli unik që kryen shërbimet për funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave në administrimin kolektiv, të mbrojtura nga të gjitha agjencitë e administrimit kolektiv të licencuara

Burimi: [link](#)

Proposal for amendments to law no.112 / 2020, "On the Register of Beneficial Owners", as amended

The draft law: On some additions and changes to law no. 112/2020, "On the Register of Beneficial Owners ", as amended, has been published in the Electronic Register for Public Notices and Consultations.

According to this draft law:

1. The deadline for initial reporting for beneficial owners for existing reporting entities is extended until 01.04.2022.
2. The fines imposed for non-fulfillment in time of the legal obligations for the initial registration, are forgiven, provided that these obligations are fulfilled within the date 01.04.2022.
3. In case of incomplete applications, the application is suspended for a period of 30 days.
4. In cases when a fine has been imposed on reporting entities and the service has been terminated in the commercial register and in the Register of Non-Profit Organizations, the change / reappointment of the administrator or legal representative of reporting entities is allowed.
5. For the administrator in case of non-registration of data of beneficial owners of reporting entities within the legal deadline, it is possible to remove the fine and include the value of this fine in the fines imposed on reporting entities.
6. For the initial reporting of beneficial owners by newly registered reporting entities, , the deadline is extended from 30 calendar days from the date of registration of reporting entities to within 40 calendar days.

Source: [link](#)

Propozim për ndryshime në ligjin nr.112/2020, "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", i ndryshuar

Në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike është publikuar projektligji: Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.112/2020, "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", i ndryshuar.

Sipas këtij projektligji:

1. Afati i raportimit fillestar për pronarët përfitues për subjektet raportuese ekzistuese, shtyhet deri më 01.04.2022.
2. Gjobat e vendosura për mospërbushje në kohë të detyrimeve ligjore për regjistrimin fillestar, falen, me kusht që këto detyrime të pëmbushen brenda datës 01.04.2022.
3. Në rast të aplikimeve të paplota, aplikimi pezullohet për një afat 30 ditor.
4. Në rastet kur ndaj subjekteve raportuese është vendosur gjobë dhe është ndërprerë shërbimi në regjistrin tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave JoFitimprurëse, lejohet mundësia e ndryshimit/riemërimit të administratorit ose të përfaqësuesit ligjor të subjekteve raportuese.
5. Për admistratorin në rastin e mosregjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese brenda afatit ligjor, mundësohet heqja e gjobës dhe përfshirja e vlerës së kësaj gjobe në gjobat e vendosura ndaj subjekteve raportuese.
6. Për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi, nga brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese, afati shtyhet në brenda 40 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese.

Burimi: [link](#)



Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al



pwc